



Kolegji AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

PLANI STRATEGJIK 2022-2026

Prishtinë, janar 2022

www.aab-edu.net | info@aab-edu.net | +383 (0) 38 600 005 | +383 (0) 48 999 003

Rr. Elez Berisha, Nr.56 10000 Prishtinë Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

I.	Hyrje.....	3
1.1.	Vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik 2018-2022.....	3
1.2.	Institucione dhe njësi të reja:	3
II.	Prioritetet dhe kahet zhvillimore të AAB	5
2.1.	Misioni i Kolegjit AAB:	5
2.2.	Vizioni - 2030.....	5
2.3.	Vlerat që na motivojnë	6
2.4.	Parimet që na udhëzojnë.....	6
2.5.	Fushat prioritare dhe filozofia e intervenimit.....	7
2.5.1.	Mësimdhënia	7
2.5.2.	Shkenca	7
2.5.3.	Ndërkombëtarizimi dhe partneriteti.....	8
2.5.4.	Studentët dhe stafi.....	8
2.5.5.	Resurset dhe mjedisi i të nxënit.....	9
2.6.	Objektivat strategjike dhe masat për arritjen e tyre	10
2.6.1.	Mësimdhënia – objektiva dhe masat strategjike.....	10
2.6.2.	Shkenca - objektiva dhe masat strategjike	11
2.6.4.	Partneriteti dhe ndërkombëtarizimi: objektiva dhe masat strategjike	12
4.6.4.	Studentët dhe personeli: objektiva dhe masat strategjike.....	13
4.6.5.	Mjedisi i të nxënit: objektivat dhe masat strategjike.....	14



I. Hyrje

1.1. Vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik 2018-2022

Një arsye tjetër për hartim të hershëm të planit të ri zhvillimor është edhe realizimi në masë të madhe i masave të parapara dhe i çapeve të vendosura në Planin 2017-2022. Në të vërtetë vlerësimi i zbatimit të këtij plani strategjik ka treguar se një numër i madh masash janë tejkualuar në masë të konsiderueshme. Në vijim paraqiten arritjet dhe tejkualimet kryesore të çapeve të vendosura në Planin Strategjik 2017-2021:

- zgjerimi i hapësirave mësimore është tejkualuar për 30 % (për të mbuluar programet e reja dhe njësitë e reja organizative),
- numri i programeve të reja dhe të akredituara për 20 % (për shkak të kërkesës për programe mjekësore),
- punësimi i personelit të ri për 40 % (si rezultat i standardeve të reja të akreditimit dhe i zhvillimit të programeve mjekësore),
- digjitalizimi i mësimdhënies dhe i shërbimeve administrative për 100 % (organizimi online i të gjitha programeve është mundësuar duke iu falënderuar efikasitetit të njësisë së programimit dhe për shkak të pandemisë Kovid-19),
- organizimi i ngjarjeve me studentët e komunitetin është realizuar para kohe, që në vitin 2019 si rezultat i posedimit të dy sallave teatrore dhe i angazhimit të shtuar të sektorit të marrëdhënieve me publikun,
- rangimi në webometrix po ashtu ka tejkualuar pritmet, si rezultat i angazhimit të personelit dhe i investimeve në hulumtime shkencore e të tjera.

1.2. Institucione dhe njësi të reja:

Në kuadër të strategjive për përcjelljen e trendëve në arsimin e lartë në Kosovë e më gjerë, AAB ka vazhduar ristrukturimin institucional dhe programor edhe pas vitit 2017:

Për këtë qëllim, janë themeluar

- Shkolla Britanike e Kosovës
- Teatri Professional “Faruk Begolli”

- Kanali Televiziv - ATV
- Instituti për Auditim dhe Kontabilitet
- Shkolla Profesionale Vivienne Academy
- Janë akredituar programe të studimeve në fushat mjekësore e të tjera
- Qendra Diagnostike Mjekësore (AMG).

Tash AAB, si pjesë e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë po hyn në një fazë të re zhvillimore. Në thelb të kësaj faze është se kanë ndryshuar kërkesat e tregut dhe të klientëve: është një proces në rritje në të cilin kërkohet më shumë se një diplomë - kërkohet kompetencë për të kryer një punë, sidomos në profesionet që kërkohen më shumë në vend dhe në Evropë. Kjo për arsye se tregu është ngopur me diploma të arsimit të lartë në shkencat sociale (sidomos në ekonomik dhe juridik) dhe tregu ka lëvizur nga studimet e përgjithshme në studime të aplikuara / profesionale dhe nga sektori publik si punëdhënës kryesor, në sektorin privat dhe (gjithnjë më shumë) në tregun evropian.

Në kontekstin e ri të krijuar nga Pandemia Covid-19, nga zhvillimet e reja shoqërore e demografike, dhe nga zhvillimet teknologjike, menaxhmenti i AAB ka vendosur që të fillojë zhvillimin e strategjisë së re institucionale një vit para përfundimit të strategjisë ekzistuese 2018-2022.

II. Prioritetet dhe kahet zhvillimore të AAB

Në vijim jepen misioni¹, vizioni, vlerat, parimet dhe fushat prioritare të intervenimit siç janë përcaktuar gjatë procesit të hartimit të Planit Strategjik 2022-2026.

2.1. Misioni i Kolegjit AAB:

AAB organizon studime të diversifikuara e cilësore me studentin në qendër, angazhohet në hulumtime cilësore të aplikuara dhe teorike, dhe ofron shërbime për komunitetin e për industrinë me qëllim të sigurimit të përvojave transformuese në funksion të zhvillimit të plotë të studentëve, stafit, partnerëve socialë e ekonomik, dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Pos kësaj, për realizimin e studimeve relevante e cilësore dhe në kuadër të realizimit të misionit të vet të tretë, AAB:

- inkurajon frymën e ndërmarrësisë, kreativitetin, të menduarit kritik, dhe vlerat universale tek studentët me qëllim të realizimit të ideve dhe projekteve inovative
- siguron një mjedis mësimor që rezulton me mobilitet social, akademik dhe profesional në zhvillimin e individit – qytetar i përgjegjshëm
- fokusohet në veprimtari botuese, kulturore dhe mediale
- zhvillon dialog dinamik me partnerët social e me komunitetin dhe
- bashkohet në rrjetet më relevante të institucioneve të arsimit të lartë e të shkencës në Evropë dhe më gjere.

2.2. Vizioni - 2030

AAB është institucion lider në vend e në rajon në aplikimin e qasjeve inovative në arsimin e lartë, në shkencë dhe në teknologji që u ofron studentëve e personelit përvoja transformuese në shërbim të zhvillimit personal dhe shoqëror në epokën e globalizimit.

¹ Shih versionin në gjuhën angleze si Shtojca 4, për lehtësim të përkthimit

2.4. Vlerat që na motivojnë

Në punën e vet personeli i AAB merr energji për përballje me sfidat e përditshme duke besuar në vlerat në vijim:

Cilësia
Inovacioni
Zhvillimi dhe transformimi personal
Integriteti akademik dhe liria e shprehjes
Diversiteti dhe gjithëpërfshirja
Përgjegjësia sociale
Përkushtimi dhe dashuria për profesionin
Mirëqenia dhe suksesi i studentëve
Autonomia institucionale

AAB mbetet në vazhdimësi e përkushtuar ndaj individit, qasjeve inovative dhe vlerave akademike e shkencore. Këto vlera përvijohen në dispozitat dhe dokumentet kryesore të AAB, përfshirë edhe Kodin Etik të AAB-së.

2.5. Parimet që na udhëzojnë

Etika profesionale, akademike e shkencore
Parimi i drejtësisë dhe trajtimit të barabartë për të gjithë
Parimi i haptësisë, transparencës dhe fleksibilitetit
Monitorimi, vlerësimi i performancës institucionale
Efektiviteti dhe efikasiteti
shanset e barabarta dhe meritokracia.

Në punën tonë 20 vjeçare kemi arritur të ndërtojmë një sërë parimesh kryesore që na udhëzojnë për të realizuar qëllimet tona gjithnjë në kontekstin e caktuar social dhe duke respektuar dhe bashkëpunuar me të tjerët. Këto parime janë ndërtuar, përshtatur dhe avancuar gjatë përvojës së individëve që përbëjnë familjen e madhe të AAB. Në Strategjinë zhvillimore 2022-2026 janë identifikuar parimet në vijim:

2.6. Fushat prioritare dhe filozofia e intervenimit

Në vijim jepet filozofia e intervenimit dhe konceptet kryesore strategjike për fushat e përcaktuara prioritare për intervenim strategjik në AAB në periudhën pesëvjeçare. Këto fusha dhe filozofia e intervenimit strategjik janë përcaktuar në një proces gjithëpërfshirës të konsultimeve me pjesëmarrësit e planifikimit strategjik.

2.6.1. Mësimdhënia

Filozofia e intervenimit strategjik:

Koncepti dominues në fushën e mësimdhënies në AAB është koncepti i mësimdhënies me studentin në qendër dhe puna autonome e studentëve. Në fazën në të cilën po hyjmë AAB do të fokusohet edhe më shumë në zbatimin e këtij koncepti në mësimdhënie, duke u nisur nga rishikimi i politikave, riaranzhimi i mjedisit mësimor, sigurimi i hapësirave për punë në grup, rishikimi i praktikave dhe metodologjisë së aplikuar në klasë, sigurimi i hapësirave të individualizuara, sigurimi i mjediseve për konsultime e të tjera. Teoria dhe praktika moderne e mësimdhënies në 100 vitet e fundit, na mëson se studenti duhet të jetë subjekt i të nxënit dhe të përfshihet në qasje ndërvepruese në klasë duke u angazhuar në përvoja relevante dhe të personalizuar të të nxënit. Koncepti didaktik është ai i përfshirjes aktive dhe ngritjes së pjesëmarrjes së studentëve jo vetëm gjatë realizimit të mësimin në klasë por të gjitha fazat në të cilat lidhet procesi mësimor.

Kjo filozofi do të përvijohet nëpër 21 masat e kësaj fushe të intervenimit, përfshirë programet për aftësimin e stafit, hartimin e kurrikulave dhe silabuseve, mënyrën e përgatitjes dhe planifikimit, praktikën e mësimdhënies në klasë, mekanizmat për sigurimin e cilësisë, planifikimin e përkrahjes me resurse, mjediset e të nxënit e të tjera. Para se të ndryshohen praktikën e tanishme, AAB do të bëjë vlerësimin e gjendjes dhe identifikimin e nevojave për ndryshim, përmirësim, avancim, e të tjera varësisht nga gjendja e konstatuar. Në këtë kontekst, është me rëndësi të analizojmë si e shohin menaxhmenti, mësimdhënësit, por edhe studentët rolin dhe vendin e vet në promovimin e plotë të konceptit të studentit në qendër. Mësimdhënia me pjesëmarrje aktive, modeli më i avancuar është koncepti didaktik me studentin në qendër dhe është ajo se çka duam të implementojmë. Për arritjen e këtij qëllimi rol të rëndësishëm do të ketë Qendra për Aftësim dhe programet e saj, por edhe programe të tjera për përkrahjen e personelit e të studentëve. Të gjitha masat e parapara synojnë të krijojnë një sistem aktiv dinamik si në klasë dhe jashtë saj në shërbim të zhvillimit të kompetencave të studentëve për zhvillim personal por edhe për t'i kontribuar zhvillimit të gjithëmbarshtëm të vendit.

2.6.2. Shkenca

Filozofia e intervenimit strategjik:

Kërkimi shkencor i Kolegjit AAB ka për qëllim avancimin, krijimin dhe përhapjen e dijes në funksion të përmirësimit të mirëqenies së shëndetit të popullatës si dhe zhvillimit kulturor shoqëror dhe ekonomik. Në Kolegjin AAB vlerat shkencore përkrijnë me vlera ndërkombëtare të integritetit shkencor dhe të lirisë akademike. Janë tri elemente kryesore që karakterizojnë veprimtarinë shkencore në kolegjin AAB: rezultatet shkencore, cilësia, dhe prania në komunitetin shkencor (output, quality and visibility). Për të krijuar rezultate shkencore dhe për të ndikuar në komunitet dhe në shoqëri së pari duhet krijuar një kulturë hulumtuese; për

të krijuar një kulturë hulumtuese duhen disa vite. Ndërkaq tregues i arritjes së këtij qëllimi është shkalla dhe sasia e kërkimit shkencor (output) në AAB dhe niveli që do të kemi arritur si kolegji shkencor. Sasia e kërkimit shkencor dhe cilësia shkencore tash matet me databaza të rëndësishme sikurse Scopusi dhe WoS, dhe kështu ne e shohim se ku jemi ne si Kolegj në këtë aspekt. Një element tjetër i rëndësishëm është vizibiliteti dhe reputacioni jonë ndërkombëtar në sektorin e shkencës.

Në këtë kontekst për AAB-në është me rëndësi që ta shndërrojmë atë nga një institucion i fokusuar kryesisht në mësimdhënie, në një institucion me aspirata për veprimtari shkencore. Në funksion të ndërtimit të kulturës hulumtuese dhe të forcimit të dimensionit shkencor janë edhe dymbëdhjetë masat e parapara në kuadër të fushës së shkencës. Këto masa janë përcjellur me përshkrimet përkatëse, me infrastrukturën, resurset financiare, motivimin e personelit, trajnimet për hulumtues, ngritja e kapaciteteve për aplikime në projekte e fonde ndërkombëtare e vendore e të tjera.

Në përmbledhje, masat e përshkruara në vijim do të jenë në funksion të krijimit të kulturës hulumtuese në AAB nëpërmjet të sigurimit të aktiviteteve shkencore (output), cilësisë, dhe vizibilitetit të kërkimeve shkencore në AAB. Në anën tjetër do të sigurohet një kalim gradual i AAB prej një institucioni kryesisht mësimdhënës, në një institucion mësimdhënës dhe hulumtues në planin pesëvjeçar.

2.6.3. Ndërkombëtarizimi dhe partneriteti

Filozofia e intervenimit strategjik:

Filozofia e intervenimit:

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar AAB synon rritjen e rrjetëzimit dhe pranisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe më gjerë. Pos kësaj, bashkëpunimi ndërkombëtar me aktivitetet e ndryshme do të jetë në shërbim të avancimit të cilësisë së mësimdhënies, hulumtimit dhe të realizimit të misionit të tretë. Ky sektor, po ashtu do të angazhohet aktivisht në realizimin e misionit të tretë nëpërmjet të sigurimit të partneriteteve dhe programeve të bashkëpunimit me industrinë, komunitetin, dhe organizata të ndryshme aktive në fushën e kulturës, artit, dhe të zhvillimit shoqëror në përgjithësi.

Për këtë qëllim janë paraparë masat përkatëse si ngritja e kapacitetit për aplikim dhe zbatim të projekteve vendore dhe ndërkombëtare. Për t'i realizuar këto qëllime të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi me universitetet ndërkombëtare dhe implementohen ato aktivitete që mundësojnë shkëmbimin e studentëve dhe stafit të kolegjit AAB me universitete të rajonit, të vendeve të hapësirës evropiane dhe jo vetëm. Në vijim parashihen politika inkurajuese për personelin e AAB për t'u angazhuar në programe të bashkëpunimit ndërkombëtar në mësimdhënie dhe në shkencë dhe për gjetjen e partnerëve ndërkombëtar për aplikim dhe implementim të suksesshëm të projekteve.

2.6.4. Studentët dhe stafi

Filozofia e intervenimit strategjik

Koncepti kryesor në fushën e personelit e të studentëve në AAB është rritja e pjesëmarrjes së personelit e të studentëve në vendimmarrje. Kjo nënkupton fuqizim të studentëve e të mësimdhënësve dhe një lloj

demokratizimi të vendimmarrjes për të shtuar përfshirjen në udhëheqjen, menaxhimin dhe zbatimin e proceseve të dakorduara bashkërisht në AAB.

Për këtë qëllim janë identifikuar disa masa dhe veprime që kanë pasur të bëjnë me studentët edhe personelin dhe jo vetëm duke u kufizuar te personeli joakademik por edhe te personeli akademik. Ndër çështjet kryesore është identifikuar shkalla e vijueshmërisë së studentëve, krijimi i sistemit të vlerësimit të performancës, vlerësimit të nevojave të sektorëve të ndryshëm dhe rritja e kapaciteteve për përmbushjen më të mirë të kërkesave e të rolit të ri të personelit e të studentëve. Me qëllim të përkrahjes së personelit e të studentëve për rolin e ri do të organizohen një sërë aktivitetesh qoftë nëpërmjet të dekanateve apo nëpërmjet të Unionit të Studentëve të AAB. Thelbësore në këtë drejtim është sigurimi i pjesëmarrjes aktive të studentëve e të personelit në organet dhe trupat e menaxhimit e të vendimmarrjes, si për shembull në këshillat mësimore e shkencore, në komisione të ndryshme etike e shkencore, në dekanate, në rektorat e në Këshillin Drejtues.

2.6.5. Resurset dhe mjedisi i të nxëniet

Filozofia e intervenimit strategjik

Infrastruktura, shërbimet teknike, logjistika janë një segment shumë i rëndësishëm i AAB-së që ndihmon të gjitha njësitë që funksionojnë brenda AAB-së. Infrastruktura dhe shërbimet teknike e logjistike janë në funksion të krijimit të kushteve sa më të mira për procesin mësimor, për kërkime shkencore dhe për bashkëpunim me komunitetin. Pra, nëse sektori i mësimdhënies planifikon me kohë hapësira adekuate për proces mësimor me studentin në qendër atëherë ne i sigurojmë me kohë hapësirat e ndara, inventarin e duhur dhe kushtet sa më të mirë për zbatimin e koncepteve përkatëse në mësimdhënie. Njësoj kur kërkohet sigurimi i hapësirave për profesor ose për punësimin e personelit të ri, laboratore edhe kabinete pune, transport i studentëve ose i personelit e të tjera.

Gjatë planifikimit strategjik grupi punues për infrastrukturë e shërbime logjistike dhe teknike ka përcjellë konceptet kryesore nga grupet e tjera akademike e shkencore dhe ka paraparë masat përkatëse për lehtësimin e zbatimit të këtyre koncepteve. Për shembull, në këtë periudhë të planit strategjik parashihet sigurimi i më shumë kabineteve për mësimdhënës, riaranzhimi i klasave dhe i tavolinave nëpër klasa, sigurimi i laboratorëve specifike për programet studimore, sigurimi i teknologjive përkatëse për të gjitha programet e të tjera. Gjithashtu parashihen edhe rregullimet e kampuseve, transportit, mirëmbajtjes, dhe shërbimet e tjera në këtë sektor.

2.7. Objektivat strategjike dhe masat për arritjen e tyre

2.7.1. Mësimdhënia – objektiva dhe masat strategjike

Objektiva strategjike 1: Të ndërtohet e konsolidohet kultura e mësimdhënies kreative dhe e vlerësimit cilësor të studentëve bazuar në qasjen me studentin në qendër dhe në punën autonome të studentëve.

AAB është e përkushtuar që të konsolidojë kulturën e mësimdhënies e të studimit të ndërtuar mbi filozofinë e studentit në qendër. Masat e kësaj strategjie janë menduar në atë mënyrë që të jenë në funksion të ndërtimit të kapaciteteve dhe të sigurimit të resurseve të duhura për realizimin e konceptit të mësimdhënies me studentin në qendër. Një qëllim tjetër do të jetë rritja e autonomisë së studentëve si në studime ashtu edhe në hulumtime. Kurrikulat dhe metodologjia e punës do të jenë të dizajnuara dhe të zbatuara në një mënyrë që në vazhdimësi rrisin angazhimin autonom dhe përgjegjësinë e studentit për zhvillimin e vet profesional. Angazhimi autonom do të kulmojë në punimet e diplomës për të gjitha nivelet e studimeve.

Rezultatet e pritura:

- Janë zhvilluar kapacitetet dhe është motivuar personeli akademik për zbatimin e konceptit me studentin në qendër (shih Masat 1.1., 1.4., 1.5., 1.6., 1.7., 1.21.)
- Programet e studimit në AAB janë bërë më relevante dhe ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave të studentëve në përputhje me nevojat e tyre (për studim e punësim), me trendët e tregut dhe me kërkesat e shoqërisë (shih Masat 1.2., 1.3., 1.14., 1.21.).
- Janë zbatuar masa të dimensionit social për ofrimin e studimeve cilësore dhe përmirësimin e performancës së studentëve (dimensioni social), përshirë studentët e komuniteteve dhe studentë me nevoja të veçanta (shih Masat 1.3. – 1.7.)
- Në AAB ofrohen trajnime cilësore për zhvillimin e personelit akademik në përputhje me nevojat e tyre për mësimdhënie cilësore me studentin në qendër (shih Masat 1.8, 1.19., 1.20).
- Është bërë digjitalizimi i mësimdhënies dhe janë ngritur kapacitetet për zbatimin cilësor të formave të mësimin të digjitalizuar në mësimdhënie (shih Masat 1.15 dhe 1.19)
- Programet e studimit shqyrtohen vazhdimisht dhe hartohen programe të reja në përputhje me kërkesat e studentëve, të tregut e të shoqërisë (shih Masat 1.10, 1.16., dhe 1.18.)
- Është shtuar llogaridhënia, transparenca dhe bashkëpunimi në procesin e mësimdhënies (shih Masat 1.9., 1.12., 1.13).

2.7.2. Shkenca - objektiva dhe masat strategjike

Objektiva strategjike 2:

Të krijohet një sistem mundësues për ngritjen e cilësisë së kërkimeve shkencore përmes përkrahjes së personelit e të studentëve për punë hulumtuese në funksion të realizimit të misionit të tretë dhe të zhvillimit shoqëror.

AAB do të vazhdojë të krijojë mekanizmat institucional dhe të ndërtojë kapacitetet për hulumtime shkencore të cilat janë në funksion të zhvillimit shkencor të mësimdhënësve e të studentëve, por edhe në shërbim të zhvillimit shoqëror e ekonomik të vendit. Kjo do të arrihet duke shtuar investimet në shkencë dhe duke u fokusuar më shumë në kërkime të aplikuara që ndihmojnë realizimin e misionit të tretë dhe i kontribuojnë zhvillimit në vend. Kërkimi shkencor do të jetë edhe një urë lidhëse në mes të personelit të AAB dhe të kolegëve në vend dhe në botë nëpërmjet të konferencave dhe projekteve të përbashkëta hulumtuese.

Rezultatet e pritura:

- Janë avancuar kushtet dhe janë ndërtuar kapacitetet për angazhim të personelit në hulumtime shkencore dhe për publikimin të rezultateve të hulumtimeve (shih Masat 2.1.-2.7., si dhe masa 2.9)
- Janë funksionalizuar Qendrat Hulumtuese nëpërmjet të angazhimit të grupeve të hulumtuesve në projekte konkrete vendore e ndërkombëtare (shih masa 2.8).
- Është shtuar numri dhe cilësia e projekteve dhe hulumtimeve shkencore në nivelin e studimeve master (shih Masat 2.10 dhe 2.11)
- Janë vendosur raporte partneriteti në mes të AAB dhe industrisë dhe janë shtuar marrëveshjet për transferin e dijes dhe të teknologjisë (shih Masa 2.12).

2.7.4. Partneriteti dhe ndërkombëtarizimi: objektiva dhe masat strategjike

Objektiva strategjike (OS 3): Të ndërtohet bashkëpunim i qëndrueshme me partner vendorë e ndërkombëtar në funksion të avancimit të cilësisë së mësimdhënies e të hulumtimit shkencor dhe rritjes së pranisë së AAB në nismat, rrjetet dhe proceset relevante evropiane (dhe më gjerë) në fushën e arsimit të lartë dhe të shkencës.

AAB është e vendosur që të hapet ndaj industrisë, partnerëve socialë, si dhe ndaj institucioneve simotra të arsimit të lartë e të shkencës. Kjo është e domosdoshme në kohën e globalizimit, avancimeve në fushën e komunikimit, përparimit të teknologjive digjitale, mësimin online dhe në distancë, ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë e të tjera. Kufijtë e vetëm në arsimin e lartë janë kufijtë dhe kufizimet që mund të kenë mbetur nga format e mësimin dhe kërkimeve tradicionale shkencore. Pandemia Covid 19 ka dëshmuar sa të rëndësishëm janë bashkëpunimi, rrjetëzimi, partneritetet dhe krijimi i sinergjive me institucionet e tjera. Krijimi i partneriteteve me industrinë tashmë ka fituar rëndësi parësore jo vetëm për sigurimin e studimeve cilësore por dhe për zhvillimin e kompetencave dhe rritjen e punësueshmërisë dhe shkallës së punësimit të studentëve. AAB do të angazhohet aktivisht për realizimin e misionit të tretë karshi industrisë, komunitetit dhe partnerëve socialë. Masta e këtij Plani strategjik do të reflektojnë këtë orientim të AAB.

Rezultatet e pritura:

- Janë ndërtuar kapacitetet e personelit dhe e studentëve për hartim dhe zbatim të projekteve vendore e ndërkombëtare (shih Masa 3.1., 3.2. dhe 3.5)
- Janë ndërtuar partneritete dhe marrëdhënie të qëndrueshme me autoritetet, industrinë dhe me partnerë ndërkombëtarë në fushën e arsimit të lartë (shih Masat 3.3 dhe 3.4.).

4.6.4. Studentët dhe personeli: objektiva dhe masat strategjike

Objektiva strategjike: Të avancohen kushtet e punës e të studimeve dhe të rritet pjesëmarrja e studentëve dhe e personelit në vendimmarrje në funksion të përmirësimit të efikasitetit në studime dhe të punësueshmërisë së të diplomuarve.

AAB është e interesuar të shtojë pjesëmarrjen e personelit dhe të studentëve në proceset kryesore në Kolegj, përfshirë udhëheqjen, menaxhimin, si dhe zbatimin e të gjitha proceseve në Kolegj. Për këtë qëllim, AAB ka hartuar masa konkrete për organizimin e pranimit të studentëve dhe të personelit, krijimin e kushteve për punë dhe studime, vlerësimin e performancës dhe pjesëmarrjen sa më të gjerë të personelit e të studentëve në vendimmarrje. Hapat e parë në këtë drejtim janë ndërmarrë me themelimin dhe konsolidimin e organizimit dhe përfaqësimit studentor në AAB.

Rezultatet e pritura:

- Janë hartuar dhe miratuar politika dhe një kornizë rregullative në përkrahje të pjesëmarrjes aktive të personelit e të studentëve në proceset akademike e në vendimmarrje në AAB (shih Masat 4.1. dhe 4.6).
- Është krijuar një sistem për përkrahjen e vazhdueshme të zhvillimit e të motivimit të personelit e të studentëve (shih Masat 4.2., 4.3., 4.4., 4.7., dhe 4.8.)
- Është krijuar dhe zbatohet sistemi për sigurimin e llogaridhënies në punë (4.5. dhe 4.6).

4.6.5. Mjedisi i të nxënit: objektivat dhe masat strategjike

Objektiva strategjike: Të zhvillohet një mjedis mundësues për mësimdhënie, studime dhe hulumtime cilësore përmes krijimit të hapësirave funksionale, sigurimit të resurseve më të avancuara materiale dhe sigurimit të menaxhimit efikas të hapësirave mësimore.

Pandemia Covid – 19 dhe zhvillimet e hovshme teknologjike kanë dëshmuar se duhet rimenduar hapësirat mësimore, pajisjet, dhe mjetet materiale për realizimin e mësimin dhe të kërkimeve shkencore në institucionet e arsimit të lartë. AAB gjatë vitit 2020 ka qenë pjesë e një projekti Erasmus Plus për hapësirat mësimore në arsimin e lartë si pjesë aktive e një konsorciumi të gjerë të 11 institucioneve evropiane të arsimit të lartë. Konceptet dhe përvojat e fituara nga hulumtimet dhe shkëmbimet në kuadër të këtij projekti janë ndarë me udhëheqjen e institucionit dhe janë aplikuar për të avancuar mjedisin e mësimdhënies dhe të nxënit në AAB. Këto përvoja reflektohen edhe në masat përkatëse në këtë Plan strategjik. Në fokus të intervenimeve të reja strategjike janë: vendosja më e madhe e studentit në qendër diversifikimi i hapësirave mësimore për të plotësuar nevojat e nduarduarta kurrikulare e jashtëkurrikulare të studentëve e të personelit të AAB.

Rezultatet e pritura:

- Janë përmirësuar kushtet e punës për personelin akademik nëpërmjet të sigurimit të hapësirave për punë akademike, konsultime dhe punë hulumtuese (shih Masa 5.1).
- Është përshtatur mjedisi i të nxënit në përputhje me konceptin e studentit në qendër (shih Masat 5.1., 5.2., 5.3., dhe 5.6.)
- Janë avancuar më tutje shërbimet bibliotekare për studentët e për personelit përmes sigurimit të mjediseve të përshtatshme dhe sigurimit të burimeve elektronike (shih Masat 5.4. dhe 5.5.).
- Janë siguruar kushtet për punë laboratorike në përputhje me kërkesat specifike të programeve (shih Masa 5.7).
- Është avancuar databaza qendrore e AAB në përputhje me nevojat e departamenteve dhe me trendët zhvillimore (shih Masa 5.9)
- Janë avancuar dhe standardizuar kushtet dhe mjediset mësimore në të tria kampuset e AAB (Prishtinë, Gjakovë dhe Ferizaj); (shih Masat 5.10. – 5.11).
- Janë avancuar kushtet për studime dhe qarkullim për personat me aftësi të kufizuara (shih Masat 5.11.)
- Krijohen kushtet teknologjike për digjitalizimin e proceseve akademike, shkencore dhe administrative (5.6. dhe 5.13).